



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 647 Prot.

Tiranë, më datë 27.04.2023

VENDIM
Nr. 225, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Restaurimi dhe rikonceptimi i objektit Harallamb Vasi” brenda kufirit Qendër Historike, me Nr. Pasurie 7/33, Zona Kadastrale 8542, me vendndodhje Lagjja “Palorto”, Bashkia Gjirokastrë, me aplikues dhe zhvillues **Harallamb Vasi** dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
 - Të paraqitet kartela e pasurisë së rifreskuar;
 - Ndërhyrja të vijë në përputhje me qendrën historike.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

